



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2023:099518  
Datë: 08.05.2024  
Numri i dokumentit: 05665213

**K.DH.SH.II.nr.961/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë,në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit/paditësit “Italian Medical Group” L.L.C, me NUI 810852469, me pronar B.A., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Salih Gjonbalaj me seli të zyrës në Prishtinë, kundër të paditurit / kundërshtarit të masës së sigurimit “Medical Center”, me seli në Gracanicë, me pronar L.D., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Florian Petani me seli të zyrës në Prishtinë , duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhomës së Shkallës Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.340/23 e datës 16/10/2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 08/05/2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** ankesa e propozuesit/paditësit “Italian Medical Group” L.L.C, me NUI 810852469, me pronar B.A., **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.340/23 e datës 16/10/2023, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale-Dhomës së Shkallës Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike në rishqyrtim dhe rivendosje .

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë KE.nr.340/23 të datës 16/10/2023, Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë i paraqitur nga propozuesi “Italian Medical Group” L.L.C, me NUI 810852469, me pronar B.A. ashtu që

kundërshtarit të masës së sigurimit “Medical Center”, me seli në Gracanicë, me pronar L.D. të i ndalohet tjetërsimi i pajisjeve medicinale dhe mjeteve të tjera të luajtshme si dhe ka refuzuar prpozimin ku është kërkuar që të obligohet kundërshtari i masës së sigurimit “Medical Center”, me seli në Gracanicë, me pronar L.D. të që t’ia kthej menjëherë pajisjet medicinale të vendosura në objekt të kundërshtarit të masës sic janë: Printer Canon Pixma, TV Philips, Ëairles Rutes, Hekur për hekurosje, Printer HD, Radiator 2000MP, Multimikser MMC 700, Tavolinë Salagiesele, Karrike Lana, Lavatriqe MFE 50, Karrika Moemax, Tavolina Ë 045, Fshes Elektrike Roventa, Printer Epson L3156, Shtrat Gjumi, Dyshek 200x140 Comodita, Makinë Karqer BD 50/60, Karrik Shanku, Karrika 805, Tablet Samsung Galaxy 10.5 Inch 6116 mm 6-2, HDD4TB, Klima AC Split Units, Hët – 140, PA-A200, BNC DC-JACK, Tavolinë Operacioni, Llama për Operacione, Autoclave për sterilizim materiale, Incubator për bebe, Krevet Spitali, Aparat për anestezion, Makinë për qarkullimin e gjakut, Projector Acer, TV Lobot me USB, Karrika Shanku, Karroce Nick Star 120, Brushë për makine e kuqe karcher, Nihon + Kohden BSM 2301 PATIEMT – Monitor, Datex – Ohmeda S5 critocal patient – monitor, Carefusion avea SIPAP, Letti Pedit Usati, Porta Scorrev Usata, Plottrona Eltt Usata, Poltrona Prel Usata, Dollap 190x220x55, dollap me lavaman 128x60x45, tavolinë për zyrë 90x80x45, dollap me lavaman 100x60x45, dollap me fjoke 245x81x48, fshes elektrike me ujë, fshes elektrike BR-83B4, karriga për zyre sp88 50, Karrika për zyre sp88 50, Karrika 802, Karrika 86 80. Si dhe ka vendosur që secila palë ndërgjyqëse i bart shpenzimet e veta të shkaktuara deri në këtë stad të procedurës si dhe procedura në këtë çështje juridike do të vazhdohet sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe në pajtim me planin e punës së gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë prpozuesi i sigurimit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Dhoma e Shkallës së Dytë të miratojë ankesën e propozuesit në tërësi, të anulohet aktvendimi KE.nr.340/23 e datës 16/10/2023, dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtojë shkresat e lëndës, pretendimet ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 208 të LPK-së, ka gjetur se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit Paditësi / propozuesi i masës së sigurimit “Italian Medical Group” L.L.C, me NUI 810852469, me pronar B.A., përmes të autorizuarit të tyre, me datë 02.05.2023, në këtë gjykatë, kanë paraqitur padi për kthimin e mjeteve financiare në emër të investimit si dhe fitimin e humbur sëbashku me propozim për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën kanë kërkuar të i ndalohet të paditurit / kundërshtarit të masës së sigurisë “Medical Center”, me seli në Gracanicë, që të i ndalohet tjetërsimi i pajisjeve medicinale dhe mjeteve tjera të luajtshme si dhe të obligohet kundërshtari i masës së sigurisë që t’ia kthej menjëherë pajisjet medicinale të vendosura në objektin e kundërshtarit. Propozuesi së bashku me kundërshtarin e masës së sigurisë kanë lidhur Kontratë mbi Qiranë më datë 01.02.2023, ku pjesë përbërëse e kësaj kontrate ka qenë edhe Aneksi. Në nenin 5 të këtij Aneksi është paraparë që pronari i Propozuesit, B.A., ka blerë aksionet e pronarit të mëparshëm dhe ka vazhduar me kontratën në bazë të marrëveshjes për investime në objektin e kundërshtarit. Propozuesi ka shprehur që në këtë objekt ka investuar në renovim deri në shumë prej 189,114.54 Euro, ndërsa në regjistrin e investimeve deri në shumë 21,192.11 Euro. Propozuesi më tej ka shprehur që konform kësaj kontrate, kundërshtari ka qenë i obliguar që propozuesit të ia prezentoj licencën e lëshar nga Ministria e Shëndetësisë. Në kesi rrethanash, propozuesi ka shprehur që ka bërë disa herë përpjekje që të merret vesh më kundërshtarin ashtu që ai të përmbush kontratën e qirasë, dhe edhe me datë 04.01.2023 i është drejtuar me njoftimin se për shkak të mospërmbushjes së kontratës, ka vendosur në shkëputje të kontratës.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së siguris ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe pretendimet nga ndërgjyqësit në seancën dëgjimore të datës 29.09.2023 sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe ka marr aktvendimin e ankimuar me arsyetim se nuk janë plotësuar kushtet të parpara në nenin 297 par 1 pika a) dhe b) të LPK-së, ka theksuar se në rastin konkret shkaqet dhe pretendimet mbi të cilat është kërkuar që të vendoset masa e sigurimit nuk janë bërë të besueshme dhe nuk janë të bazuara, si dhe nuk i ka ofruar prova të besueshme gjykatës se në rast se masa e sigurimit nuk caktohet, do të pësoj dëme të menjëhershme dhe të riparueshme, andaj nga kjo bazë gjykata në shkallë të parë ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes Dhoma e Shkallës së Dytë, i ka vlerësuar si të bazuara thëniet ankimore të propozuesit të masës së sigurisë, nga se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 pika b) dhe 182.2 pika n) të LPK-së, për të cilin shkak duhet të priset. Shkelja thelbësore e dispozitave të

procedurës kontestimore qëndron në faktin se arsyetimi i aktvendimit të ankimuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare për marrjen e një aktvendimi të ligjshëm, ndërsa arsyet e dhëna janë të paqarta, kurse lidhur me faktet vendimtare eksitojnë kundërthënie midis asaj që thuhet në arsyet e aktvendimit dhe përmbajtës së provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar dhoma e shkallës së parë pavarësisht përshkrimit të detajuar të procedurës së zhvilluar dhe deklarimeve të palëve, nuk ka vlerësuar fare nëse janë plotësuar kushtet nga neni 297 par.1 pika a dhe b të LPK-së. Në tërë arsyetimin e aktvendimit të ankimuar vetëm është referuar në dispozitat e Nenit 297 par. 1, por nuk është dhënë asnjë fakt i vërtetuar dhe asnjë arsye pse gjykata ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës siguroese.

Sipas nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se: “ *Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së kështillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.*

Gjykata në shkallë të parë ka gjetur se në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi i sigurimit në këtë fazë të procedurës, nuk ka ofruar prova bindëse lidhur me besueshmërinë e kërkesës së tij, me të cilat do të vërtetonte pretendimet tij lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Po ashtu në rastin konkret nuk plotësohet as kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurimit sepse paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë se kundërshtareve të sigurimit do të mund të pamundësojë apo vështirësojë dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Kështu, dhoma e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye se pse nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet e nenit të lartëcekur ashtu që pse propozuesi i masës së sigurimit nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin dhe besueshmërinë se pa një masë të tillë kundër propozuesi do të pamundësonte apo vështirësonte në mënyrë të dukshme realizimin e kërkesës , dhe nëse ekziston rreziku se pa caktimin e masës së propozuar, kundër propozuesi do ta vështirësonte dukshëm

realizimin e kërkesë padisë e sidomos me tjetërsimin e pasurisë me fshehjen e saj, me ngarkimin apo ndonjë mënyrë tjetër do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese.

Andaj, sipas nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e palës propozuese për caktimin e masës siguruese ndaj kundër propozuesit të masës së sigurisë, pa qartësuar plotësisht pse nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, respektivisht pa i vërtetuar me prova konkrete faktet vendimtare kontestuese sepse nga arsyetimi i aktvendimit të ankimuar nuk është e qartë se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur te përfundimi se propozimi i palës propozuese për caktimin e masës siguruese është i pabazuar.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktvendimi i ankimuar doemos është dashur të priset.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në ri-procedurë t'i evitoj të gjitha të metat të cekura më lartë, t'i vërtetoi faktet relevante të sipërpërmendura, t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha provat e nevojshme për të vlerësuar nëse janë plotësuar kushtet nga neni 297.1 dhe nenin 297.2 të LPK-së, ashtu që pastaj lidhur me masën e propozuar të vendos drejt dhe sipas Ligjit.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

### **-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.961/24 të datës; 08.05.2024

**Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja**

Saranda Bogaj Sheremeti